Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*
*Centralna Izborna Komisija*
*Central Election Commission*

# PLANI PUNËS I KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2016

Dhjetor, 2015

**www.kqz-ks.org**

# Shkurtesat

| | |
|---|---|
| ACEEEO | Asociacioni i Zyrtarëve Zgjedhor Evropian |
| IFES | Fondacioni ndërkombëtar per sisteme zgjedhore |
| KKZ | Komisionet Komunale të Zgjedhjeve |
| KQZ | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve |
| KVV | Këshillat e vendvotimeve |
| OJQ | Organizatat Jo Qeveritare |
| OSCE | Organizata per siguri dhe bashkëpunim ne Evropë |
| QNR | Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve |
| QV | Qendra e Votimit |
| SKQZ | Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve |
| VV | Vendvotim |
| SHV | Shërbimi Votues |
| LV | Lista e Votuese |
| ZFK | Zarfi i Fletëvotimit me Kusht |
| FPR | Formulari i Përputhjes së Rezultateve |
| FRK | Formulari i Rezultateve të Kandidatëve |
| DAP | Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes |
| DOZ | Departamenti i Operacioneve Zgjedhore |
| DTI | Departamenti i Teknologjisë Informative |
| KT | Koordinimi ne teren |
| KOZ | Këshilli për Operacione Zgjedhore |
| KP | Këshilli për Personel |
| KBF | Keshilli per Buxhet dhe Financa |
| KA | Komiteti i Auditimit |
| KÇL | Këshilli për Çështje Ligjore |
| KMJ | Këshilli për marrëdhënie me jashtë |
| ZRPP | Zyra për Regjistrim të Partive Politike |

## Hyrje

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është institucion i pavarur i themeluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas nenit 139, paragrafi 1 "është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre". Në përmbushjen e këtyre detyrave dhe obligimeve kushtetuese, KQZ-ja mbështetet nga dy trupa administrative siç janë, Sekretariati i KQZ-së dhe Zyra për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike.

Me qëllim të implementimit të përgjegjësive dhe detyrave të veta harton dhe miraton ketë Plan të Punës për vitin 2016 i cili paraqet prioritetet e institucionit për vitin 2016 dhe jep përmbledhje të aktiviteteve të planifikuara për realizimin e synimeve operative të përcaktuara. Po ashtu, i njëjti përcakton edhe afatet kohore, përgjegjësit për kryerjen e secilit prej aktiviteteve dhe objektivave të parapara, si dhe koston financiare.

## Përbërja

Përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është e përcaktuar me Kushtetutë. Neni 139, paragrafët 2, 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e rregullojnë saktësisht përbërjen dhe emërimin e, kryesuesit të KQZ-së dhe anëtarëve të KQZ-së si në vijim: Komisioni përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli dhe gjashtë (6) anëtarë të cilët emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend. Një (1) anëtarë emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.

## Përgjegjësitë dhe funksionet

Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, janë përcaktuar në mënyrë të përgjithshme përgjegjësitë dhe funksionet e KQZ-së, ndërsa me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, janë përcaktuar në mënyrë më të specifikuar këto përgjegjësi dhe funksione të KQZ-së duke përfshirë edhe ato të Sekretariatit të KQZ-së dhe Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike.

Neni 64 i këtij Ligji përcakton qartë përgjegjësitë dhe funksionet e KQZ-së, si:

a) përgatitja dhe shpallja e rregullave, formave dhe procedurave zgjedhore që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji dhe me çdo çështje tjetër që ka të bëjë me drejtimin e zgjedhjeve në kuadër të kompetencës së saj;

b) publikimi i të gjitha rregullave të miratuara, rregullave, udhëzimeve dhe procedurave zgjedhore duke i bërë ato të arritshme për opinionin;
c) krijimi dhe mbajtja e listës së personave që kanë të dejtë të votojnë në zgjedhje të veçanta;
d) mbajtja e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikimin e Partive Politike në mënyrën e paraparë me këtë ligj;
e) përpilimi dhe miratimi i fletëvotimeve dhe materialet tjera zgjedhore;
f) akreditimi i vëzhguesve zyrtarë të zgjedhjeve;
g) certifikimi i listës së votuese lidhur me zgjedhjet;
h) certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve;

## Këshillat e KQZ-së

Në bazë të Rregullores së Punës, Komisioni ka 5 këshilla të përhershëm:

a) Këshilli për marrëdhënie me jashtë
b) Këshilli për Personel
c) Këshilli për Buxhet dhe Financa
d) Këshilli për Çështje ligjore
e) Këshilli për Operacione zgjedhore.

Gjithashtu KQZ ka themeluar edhe Komitetin e Auditimit.

Roli i këshillave është shqyrtimi i çështjeve të caktuara dhe përgatitja e rekomandimeve apo raporteve për miratim nga KQZ-ja.

# Plani vjetor i punës

Plani Vjetor i Punës përcakton në mënyrë të detajuar të gjitha veprimet të cilat duhet të ndërmerren për t'i arritur synimet dhe objektivat e vëna strategjike.

Ky Plani i Punës, gjithashtu, identifikon aktivitetet konkrete, bartësit, orarin kohor, treguesit e përformancës, caqet dhe kërkesat buxhetore për zbatimin e secilës masë dhe aktivitet. Identifikimi i këtyre masave dhe aktiviteteve është bërë në bashkëpunim të ngushtë në mes anëtarëve të Komisionit dhe Sekretariatit.

Me miratimin e Planit vjetor të Punës për vitin 2016, KQZ merr përsipër angazhimet dhe përgjegjësitë në lidhje me zbatimin e këtij plani. Menaxhmenti dhe stafi i Sekretariatit, përmes kontributit të tyre në identifikimin e veprimeve dhe aktiviteteve konkrete gjatë hartimit të Planit të Punës, njëkohësisht zotohen se do të përfshihen dhe do ta zbatojnë këtë plan.

Plani i Punës është bazuar në synimet dhe objektivat e përgjithshme dhe synimet dhe pikat e referencës që janë përcaktuar ne Planin Strategjik te KQZ-së dhe obligimet tjera ligjore të cilat në Planin e Punës, ato me prioritet dhe më kryesoret, janë zbërthyer ne aktivitete konkrete.

Plani i Punës është i ndare ne tetë fusha kryesore që ndërlidhen me shtyllat strategjike të Planit Strategjik të KQZ-së 2015-2018 dhe aktivitetet tjera te mbështetura nga OSCE.

Meqë ky Plan i Punës është një dokument qe duhet t'i përshtatet rrethanave, nevojave dhe mundësive buxhetore të KQZ-së, në çdo 3 (tre) muaj duhet të raportohet për rrjedhat e implementimit të tij, si dhe të shqyrtohet ne mesin e vitit, përkatësisht ne muajin qershor .

Së fundmi duhet pasur parasysh se për implementimin e plotë të këtij Plani, është më se e domosdoshme përkrahja nga organizatat dhe donatoret e jashtëm. Në rast se nuk arrihet të sigurohen donacione, atëherë aktivitetet që janë planifikuar që të mbulohen nga donatore te jashtëm, nuk do të mund të realizohen ashtu siç është planifikuar.

## Rreziqet dhe pengesat në implementimin e Planit të Punës -2016

Rreziqet dhe pengesat në implementimin e Planit të Punës për vitin 2016 mund të jenë:

A. Limitet buxhetore;
B. Mungesa e mbështetjes nga donatorët,
C. Mungesa e hapësirës së mjaftueshme për punë.
D. Trajtimit jo i duhur i KQZ-së nga ana e institucioneve të Kosovës.

# SHTYLLA STRATEGJIKE 1: Operacionet Zgjedhore

## SYNIMI STRATEGJIK 1 Aktivitete zgjedhore të planifikuara me saktësi

| VEPRIMET STRATEGJIKE | | AKTIVITETET | PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE | DEPARTAMENTI / NJËSIA PËRGJEGJËS PËR ZBATIM | PËRGJEGJËS PËR MONITORIM | AFATI KOHOR | | TREGUESIT E PERFORMANCËS | | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | FILLIMI | PËRFUNDIMI | TREGUESI | CAQET / OBJEKTIVI I 2016 | VLERËSIMI I BUXHETIT |
| 1.1.1. Sigurimi i kornizës buxhetore për implementimin e strategjisë | 1 | Miratimi i planit final të prokurimit për vitin 2016 | KQZ brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2016, do të përgatisë dhe dorëzojë në APP, një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detale të arsyeshme të gjitha | Prokurimi | KBP/KQZ | 1 Janar | 31 Janar | Plani final i prokurimit i miratuar | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 2 | Hartimi i planit preliminar te prokurimit për vitin 2017 | Jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, KQZ do të dorëzojnë në APP një planifikim paraprak të prokurimit, me shkrim, në të cilin identifikojnë me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që KQZ parasheh t'i prokurojë gjatë vitit fiskal 2017. | Prokurimi | KBF/KQZ | 1 Tetor | 1 Nëntor | Plani preliminar I prokurimit i hartuar | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 3 | Hartimi i planit te buxhetit për vitin 2017 - 2019 | Pas aprovimit te KASH 2017-2019 nga Kuvendi i Kosovës, fillon procesi i hartimit te Planit te Buxhetit 2017-2019 te KQZ-se. Hartimi i Planit te Buxhetit bazohet ne kërkesat buxhetore të cilat janë te bazuara ne plane dhe projekte te njësive kërkuese. Dokumenti i pare i planit te buxhetit bazohet ne Qarkoren buxhetore2017/ 01 dhe dorëzohet ne MF ne muajin qershor. Më Qarkoret buxhetore 2017/ 02- korrik; 2017/03 gusht- shtator te MF caktohen kufijtë final dhe kufijtë e forte buxhetor ne baze te cilëve duhet te rishikohet buxheti i planifikuar i KQZ-se dhe te përshtatet me qarkore buxhetore. | DAP | KBF/KQZ | 1 Qershor | 1 Shtator | Plani i buxhetit i hartuar dhe miratuar | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 4 | Implementimi i Planit të Prokurimit për vitin 2016 | KQZ implementon Planin e Prokurimit për vitin 2016, duke zhvilluar aktivitetet e parapara me plan për prokurimin e shërbimeve apo furnizimeve. | Prokurimi | KBF/KQZ | Janar | Dhjetor | Zbatimi i aktiviteteve te planifikuar ne Plan | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 5 | Korniza afatmesme e shpenzimeve 2017 -2019 | Hartimi i Kornizës Afatmesme te Shpenzimeve 2017-2019 është dokument qe i paraprinë procesit buxhetor dhe shërben për realizimin e strategjisë dhe qëllimeve te KQZ-se përmes objektivave qe realizohen përmes aktiviteteve dhe projekteve ne një vit te rregullt buxhetor.ky dokument ne MF dorëzohet ne fillim te muajit prill. | DAP | KBF/KQZ | 1 Mars | 1 Prill | Dokumenti i KASH-it i hartuar dhe miratuar | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 6 | Rishikimi i Buxhetit dhe Planit te Prokurimit te KQZ- së për vitin 2016 | Rishikimi i buxhetit për vitin 2016 ka te beje me rregullimet e brendshme te arsyeshme buxhetore për te bere efikas zbatimin e buxhetit për periudhën e mbetur te vitit buxhetor. Me rishikim te buxhetit i cili duhet te dorëzohet ne fillim te muajit qershor mund te kërkohen fonde shtese për përmbushjen e ndonjë objektivi apo aktiviteti deri ne fund te vitit fiskal. | Dap/Prokurimi | KBF/KQZ | 1 Maj | 30 Qershor | Buxheti I rishikuar Plani I Prokurimit i rishikuar | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 7 | Raporti financiar (9 -mujor) | Jo më vonë se me 31 Tetor të çdo viti kalendarik, Organizatat buxhetore do të përgatitë dhe dorëzojë MF ,një raport përfundimtar përmbledhës të buxhetit për 9 mujorin vitit aktual fiskal dhe 9 mujorët e dy vitet paraprake fiskale, i cili përfshin: te dhënat sipas nenit 46 te ligjit për Menaxhimin e Financave publike dhe Përgjegjësit. | DAP | KBF/KQZ | 1 Tetor | 30 Tetor | Raporti i hartuar dhe miratuar nga KQZ | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| 1.1.2. Të sigurohet planifikim gjithëpërfshirës i aktiviteteve të KQZ-së | 8 | Hartimi i planit te punës te KQZ-se për vitin 2017 | KQZ harton planin e Punës për vitin 2017, bazuar ne Planin Strategjik të KQZ-së 2015-2018 | SKQZ | KOZ/KQZ | 1 Nëntor | 15 Dhjetor | Plani i punës së KQZ-së i hartuar | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 9 | Rishikimi i Planit te Punës për vitin 2016 | Pas muajit qershor, konform edhe rishikimeve buxhetore, nëse është e nevojshme KQZ bën ri formatimin e aktiviteteve te Planit të Punës. | SKQZ | KOZ/KQZ | 1 Maj | 30 Qershor | Plani i punës së KQZ-së i rishikuar | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 10 | Analizë e krijimit të Listës së Votuesve dhe votave me kusht | Plotësimi i Master-Listës, si mekanizëm i caktimit të votuesve edhe me emërtime të rrugëve në bazë të sistemit unik të adresave,<br><br>Themelimi i qendrave të reja të votimit në zonat urbane,<br><br>Krijimi i një sistemi hartografik përmes se cilit do të bëhej ndërlidhja e adresës se votuesve me qendrën e votimit dhe përcaktimi automatik i QV për votuesit te cilët e kanë adresë: matjet e gjatësisë, identifikimi i adresave, i QV-ve dhe ndarja e zonave të caktuara dhe përcaktimi i adresave në kuadër të QV-së. Identifikimi i shkaqeve të votimit me kusht duke analizuar të dhënat e Ekstraktit të fundit që është pranuar nga Agjencia për Regjistrim Civil/ Lista përfundimtare e Votuesve. | DOZ | KOZ/KQZ | 5 Prill | 25 Shtator | Raporti i analizës i përfunduar | n/a | Buxheti i KQZ-së |
| | 11 | Raport lidhur me implementimin e Planit të Punës 2016 | Pas çdo tre mujori, sekretariati përgatitë raport lidhur me implementimin e Planit të Punës për periudhën përkatëse. | SKQZ | KOZ/KQZ | 1 Prill | 15 Dhjetor | Raportet tremujore të dorëzuara brenda afatit | n/a | Buxheti i KQZ-së |

### SYNIMI STRATEGJIK 2 Procedura të thjeshtësuara zgjedhore

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.2.1 Formularët zgjedhor të thjeshtëzuar | 12 | Thjeshtëzimi, testimi dhe ridizajnimi i formularëve zgjedhor | Formularët zgjedhor të thjeshtëzuar në mënyrë që të plotësohen më lehte nga stafi zgjedhor. Formular zgjedhor të dizajnuar që të jenë më lehte të kuptueshëm nga votuesit. | QNR/DOZ/DTI/DAP | KOZ/KQZ | 10 Prill | 25 Shtator | Rishikimi i formularëve zgjedhor i përfunduar | | Buxheti i KQZ-së |
| 1.2.2 Rishikimi i procedurave zgjedhore, dhe përshtatja me praktikat më të mira | 13 | Rishikimi i Procedurave të QNR-së | Rishikimi i Procedurave të QNR-së me qëllim të identifikimit të nevojave për përmirësim aty ku është e aplikueshme | QNR | KÇL/KOZ/KQZ | 15 Janar | 25 Maj | Procedura të rishikuara | | Buxheti i KQZ-së |

### SYNIMI STRATEGJIK 3 Votim më i qasshëm për votuesit

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.3.1 Ofrimi i mundësisë për votuesit që të votojnë afër vendbanimeve të tyre. | 14 | Vlerësimi i arsyeshmerisë për themelimin e qendrave të reja të votimit | Themelimi i qendrave të reja të votimit në mënyrë që votuesit të votojnë sa më afër vendvotimit | KT/DOZ | KÇL/KQZ | 15 Janar | 10 Shtator | Raport lidhur me nevojën e themelimit të QV-ve te reja | 100% | Buxheti i KQZ-së |
| 1.3.2 Sigurimi që të gjitha shërbimet zgjedhore të jenë të qasshme për votuesit | 15 | Nënshkrimi i Marrëveshjes së mirëkuptimit me Ministrinë e Arsimit për të siguruar qasje për të gjithë votuesit në të gjitha shkollat të cilat përdoren si vendvotime | KQZ përmes memorandumit me MASHT do te ofrojnë mundësi te barabarta për personat me aftësi te kufizuara qe ky entitet te ketë te lehte qasjen neper objekte arsimore ku mbahen zgjedhjet. | DÇL/KT | KÇL/KQZ | 15 Janar | 25 Maj | Memorandumi i nënshkruar | 100% | Buxheti i KQZ-së |
| | 16 | Nënshkrimi i Marrëveshjes së mirëkuptimit me Ministrinë e Arsimit për të siguruar qasje për të gjithë votuesit në të gjitha shkollat të cilat përdoren si vendvotime | KQZ përmes memorandumit me MAPL do te ofrojnë mundësi te barabarta për personat me aftësi te kufizuara qe ky entitet te ketë te lehte qasjen neper objekte Komunale ku gjinden Zyrat e KKZ-ve. Për tu krijuar mundësi te rrisin aftësitë e tyre përmes punësimit te tyre si staf jo permanent apo permanent ne SKQZ qe te kenë me te lëshetë qasjen neper zyrat ku administrohen zgjedhjet. | DÇL/KT | KÇL/KQZ | 11 Janar | 15 Mars | Memorandumi i nënshkruar | 100% | Buxheti i KQZ-së |
| | 17 | Analizë lidhur me zbatimin të projektit për votuesit e verbër | Identifikimi i problemeve të mundshme, që kanë pasë të bëjnë me zbatimin e këtij projekti në terren, në ditën e zgjedhjeve.<br>Takime me Shoqatën, lidhur me atë se sa është zbatuar ky projekt, cilat kanë qenë problemet, sa janë shpërndarë dhe përdorë shabllonet e fletëvotimeve në alfabetin e BRAI-t në qendra të votimit në ditën e zgjedhjeve, identifikimin eventual të mënyrave më të lehta për prodhimin dhe përdorimin e shablloneve. | DOZ | KOZ/KQZ | 10 Korrik | 25 Shtator | Raporti i analizës i përfunduar | 100% | Buxheti i KQZ-së |

### SYNIMI STRATEGJIK 4: Rezultate të zgjedhjeve të sakta dhe të shpejta

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.4.1 Kërkimi dhe zbatimi i një sistemi më të mirë, me qëllim të përshpejtimit të futjes, tabulimit dhe raportimit të rezultateve | 18 | Rishikimi dhe avancimi i tabulimit dhe prezantimit të rezultateve | | DOZ | KOZ/KQZ | 1 Korrik | 10 Dhjetor | Dokument-analiza e përfunduar | n/a | Buxheti i KQZ-së |

## SHTYLLA STRATEGJIKE 2: Edukimi dhe informimi i votuesve

### SYNIMI STRATEGJIK 1: Votues të informuar për të drejtat zgjedhore dhe të motivuar për rëndësinë e realizimit të tyre

| VEPRIMET STRATEGJIKE | | AKTIVITETET | PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE | DEPARTAMENTI / NJËSIA PËRGJEGJËS PËR ZBATIM | PËRGJEGJËS PËR MONITORIM | AFATI KOHOR | | TREGUESIT E PERFORMANCËS | | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | FILLIMI | PËRFUNDIMI | TREGUESI | CAQET / OBJEKTIVI I 2016 | VLERËSIMI I BUXHETIT |
| 2.1.2 Përshtatja e një kornize më të avancuar për informim publik | 19 | Hartimi i Strategjisë për Edukimin dhe Informimin e Votuesve | Hartimi i strategjisë ka për qëllim informimin dhe edukimin e votuesve dhe palëve tjera relevante me informacion zgjedhor lidhur me Zgjedhjet për, rritjen e pjesëmarrjes në votim, për rrjedhojë dhe minimizimin e të gjithë elementëve, të cilët mund të cenojnë integritetin e procesit zgjedhor, uljen e numrit të fletëvotimeve të pavlefshme, si dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për rolin e tyre në mbajtjen e një procesi të rregullt zgjedhor. | DOZ | KOZ/KQZ | 18 Janar | 20 Maj | Dokumenti i përfunduar | 100% | Buxheti i KQZ-së / Donator |

### SYNIMI STRATEGJIK 2: Komunikimi i përhershëm me publikun në formë të qasshme

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.2.1 Të rrisim në mënyrë të vazhdueshme njohuritë zgjedhore të grupeve të shënjestruara | 20 | Edukimi dhe informimi i votuesve te rinjë | Rritja e pjesëmarrjes së votuesve të rijnë në zgjedhje | DOZ/ZLKZ | KOZ/KQZ | 1 Shtator | 30 Shtator | Votuesit e rijnë te informuar për zgjedhjet | Afërsisht 12,000 nxënës te viteve te fundit te shkollave te mesme | Buxheti i KQZ-së/IFES |

## SHTYLLA STRATEGJIKE 3: Fuqizimi Institucional

| VEPRIMET STRATEGJIKE | | AKTIVITETET | PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE | DEPARTAMENTI / NJËSIA PËRGJEGJËS PËR ZBATIM | PËRGJEGJËS PËR MONITORIM | AFATI KOHOR | | TREGUESIT E PERFORMANCËS | | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | FILLIMI | PËRFUNDIMI | TREGUESI | | |
| **SYNIMI STRATEGJIK 1: Ruajtja e stafit plotësisht të trajnuar, profesional dhe gjithëpërfshirës** | | | | | | | | | | |
| 3.1.1 Sigurimi që stafi i KQZ-së të ketë një trajtim të barabarte me institucionet tjera të pavarura si kategori kushtetuese | 21 | Nivelizimi i pagave dhe shpërblimeve për stafin e SKQZ-se duke u bazuar në analizë. | | DAP | KP/KQZ | 15 Janar | 10 Qershor | n/a | n/a | |
| | 22 | Rishikim i procedurave te KQZ-se për zgjedhjen e stafit te përkohshëm. | Rishikim i procedurave te KQZ-se për zgjedhjen e stafit te përkohshëm për promovimin e pjesëmarrjes se grave, komuniteteve pakicë dhe personave me aftësi të kufizuara, si staf administrativ dhe trupa menaxhuese te zgjedhjeve | DAP | KP/KÇL/KQZ | 12 Shtator | 10 Dhjetor | Procedurat e rishikuara dhe te aprovuara | 100% | Buxheti i KQZ-së |
| 3.1.2 Përmirësimi i sistemit për zhvillim profesional të stafit | 23 | Organizimi i Simulimit të Procesit Zgjedhor. | SKQZ do te beje testimit te aftësive, vigjilencës, saktësinë e stafit te SKQZ-se se sa janë te përgatitur ne menaxhimin e situatave ne ditën Z. | KT | KOZ/KQZ | 15 Gusht | 25 Shtator | n/a | n/a | Buxheti i KQZ-së |
| | 24 | Përkthimi dhe publikimi i librave/ publikimeve . | Me rishikimin e buxhetit apo gjetja e donatorëve për përkthime dhe publikime | DOZ/DAP | KOZ/KQZ | 15 Shkurt | 21 Nëntor | Libra/publikime te përkthyera | Te paktën 2 libra/publikime te përkthyera | Buxheti i KQZ-së / Donator |
| | 25 | Zbatim i aktiviteteve të trajnimeve sipas planit të aprovuar të trajnimit për vitin 2016 | Staf profesional të SKQZ-së | DOZ/DAP | KP/KQZ | 15 Janar | 9 Dhjetor | Trajnime te mbajtura | Te paktën 14 trajnime | Buxheti i KQZ-së / IFES |
| | 26 | Hartimi i planeve për zhvillim personal për stafin e SKQZ | | DAP | KP/KQZ | 11 Janar | 30 Mars | Planet për zhvillim personal të përfunduara | 80% | Buxheti i KQZ-së / IFES |
| 3.1.3 Të përmirësohen kushtet për punë | 27 | Sigurimi i hapësirave të punës (zyrat, depo dhe arkivë) | | DAP | KQZ | 14 Qershor | 25 Shtator | n/a | n/a | Buxheti i KQZ-së |
| **SYNIMI STRATEGJIK 2: Komunikim më efikas institucional** | | | | | | | | | | |
| 3.2.2 Te zhvillohet një plan për përmirësimin e komunikimit të brendshëm si në nivel horizontal ashtu edhe në atë vertikal | 28 | Mbajtja e takimeve të rregullta me ZLKZ-të | SKQZ përmes ZLKZ-ve te komunave përkatëse do te organizon takimet ne nivel komunal me SP,OJQ-te, Kryetar Komunave, PK, Partneret Ndërkombëtar ku do te diskutohen, përvojat, problemet dhe sfidat e mundshme për procese zgjedhore, me ç 'rast synim kryesor i këtyre takimeve është ngritja e vigjilencës dhe e bashkëpunimit për organizimin e zgjedhjeve ne nivel komunal neper komunat përkatëse. | KT | KOZ/KQZ | 11 Janar | 20 Dhjetor | Takime te mbajtura | Se paku 6 takime te përbashkëta | Buxheti i KQZ-së |
| **SYNIMI STRATEGJIK 3: Trupa zgjedhore (KKZ dhe KVV) kompetente dhe efektive** | | | | | | | | | | |
| 3.3.2 Përmirësimi i trajnimit të trupave zgjedhore | 29 | Analizimi dhe plotësim/ndryshimi i doracakut te trajnimit | Doracak i cili përmbush standardet zgjedhore | DOZ | KOZ/KQZ | 11 Janar | 4 Prill | Doracaku i rishikuar dhe i miratuar | 100% | Buxheti i KQZ-së |
| | 30 | Hartimi i Procedurës për Operacionin e votim jashtë Kosovës | Hartimi i një dokumenti unik për procedurën e votimit jashtë Kosovës, Përfshirja e të gjitha hapave të votimit jashtë Kosovës (Përshkrim i procesit për regjistrimin e votuesve, Periudhën e votimit dhe vlerësimit të pakove me fletëvotime. | DOZ | KOZ/KQZ | 12 Shtator | 15 Nëntor | Procedura e hartuar dhe miratuar | 100% | Buxheti i KQZ-së |
| | 31 | Trajnimi dhe certifikimi deri në tre përfaqësues të subjekteve politike për secilën komunë për detyrat dhe përgjegjësitë e KKZ-së | Pajisjen me njohuri te duhura profesionale për personat te cilët do ti përfaqësojnë subjektet e tyre politike gjatë procesit zgjedhore ne 38 Komunat te Republikës se Kosovës dhe certifikimi i tre përfaqësuesve nga secili subjekt politik. Ne këtë mënyrë do te krijohen prioritete për nominime dhe emërime në bazë te kualifikimit dhe certifikimit. Këta persona do te jenë si kandidat potencial për tu emëruar anëtarë te KKZ-ve. | DOZ/ DÇL | KOZ/KQZ | 11 Janar | 27 Maj | Kandidat te trajnuar dhe certifikuar | Se paku 380 kandidat te trajnuar/certifikuar | Buxheti i KQZ-së |
| | 32 | Hartimi i programit për trajnimin e stafit jo permanent për proceset zgjedhore | Trajnim i plotë i trupave menaxhues zgjedhor | DOZ,DAP/SKQZ | KP/KQZ | 11 Prill | 2 Dhjetor | Programi i hartuar dhe miratuar | 100% | Buxheti i KQZ-së |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 33 | Zhvillimi i programeve për e-mësimit (e-learning) për Platformën për Modernizim të Zgjedhjeve | Zhvillimi i programeve interaktive te trajnimit, te cilat do te jene te qasshme online dhe inkorporohen ne modulin për trajnime online. | DOZ/DTI | KOZ/KQZ | 7 Mars | 13 Maj | Programe te zhvilluara | 100% | Buxheti i KQZ-së / IFES |

## SYNIMI STRATEGJIK 4: Strukturë organizative në pajtim me qëllimet e KQZ-së

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.4.1 Fuqizimi i strukturës organizative në pajtim me qëllimet strategjike të KQZ-së | 34 | Zhvillimi dhe Implementimi i planit për Monitorim dhe Vlerësimin e Strategjisë KQZ-së | | SKQZ | KQZ | 11 Janar | 22 Dhjetor | Plani i M&V i hartuar dhe miratuar | n/a | Buxheti i KQZ-së / IFES |
| | 35 | Zbatimi i rekomandimeve te miratuara nga rishikimi i strukturës për sa i përket administrimit | | SKQZ | KQZ | 11 Prill | 15 Dhjetor | Rekomandimet e miratuar | 50% | Buxheti i KQZ-së |

## SYNIMI STRATEGJIK 5: Qëndrueshmëri financiare

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.5.1 Fuqizimi i koordinimit me MEF-in dhe Kuvendin e Kosovës me qëllim të sigurimit të mjeteve të vazhdueshme financiare | 36 | Takime te rregullta me Ministrinë e Financave dhe me Kuvendin e Kosovës për sigurimin e buxhetit të nevojshëm për implementimin e Planit Strategjik 2015-2018 | | SKQZ/KQZ | KQZ | 18 janar | 8 Dhjetor | Takime te mbajtura | Se paku 3 takime | Buxheti i KQZ-së |
| 3.5.2 Forcimi i kapaciteteve për të marrë fonde jashtë buxhetit të KQZ-së | 37 | Formimi i grupit punues për koordinim me organizatat ndërkombëtare | KQZ do te hartoje një liste të projekteve, të cilin do ta prezantoje para organizatave ndërkombëtare me qellim te financimit. Se bashku me listën, për projekte do të hartohen Koncept-projektet me te informata si Qëllimi, objektivat, aktivitetet, kohëzgjatja dhe kosto. | SKQZ/KQZ | KQZ | 18 Janar | 11 Mars | Grupi punues i formuar | n/a | Buxheti i KQZ-së |

# SHTYLLA STRATEGJIKE 4: Lista e votuesve

## SYNIMI STRATEGJIK 1:Një listë të votuesve të saktë dhe të plotë

| VEPRIMET STRATEGJIKE | | AKTIVITETET | PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE | DEPARTAMENTI / NJËSIA PËRGJEGJËS PËR ZBATIM | PËRGJEGJËS PËR MONITORIM | AFATI KOHOR | | TREGUESIT E PERFORMANCËS | | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | FILLIMI | PËRFUNDIMI | TREGUESI | CAQET/OBJEKTIVI I 2016 | VLERËSIMI I BUXHETIT |
| 4.1.1 Përshtatja e mekanizimit të caktimit të votuesve, me sistemin e adresave në Kosovë | 38 | Përmirësimi dhe qëndrueshmëria e Listës së Votuesve, " Vendbanimi im, Vendvotimi im" | Plotësimi i Master-Listës, si mekanizëm i caktimit të votuesve edhe me emërtime të rrugëve në bazë të sistemit unik të adresave. Themelimi i qendrave të reja të votimit në zonat urbane. Krijimi i një sistemi hartografik përmes se cilit do të bëhej ndërlidhja e adresës se votuesve me qendrën e votimit dhe përcaktimi automatik i QV për votuesit te cilët e kanë adresë: matjet e gjatësisë, identifikimi i adresave, i QV-ve dhe ndarja e zonave të caktuara dhe përcaktimi i adresave në kuadër të QV-së. | DOZ | KOZ/KQZ | 4 Prill | 14 Dhjetor | n/a | n/a | Buxheti I KQZ-së / IFES |
| 4.1.2 Përmirësimi i koordinimit me ARC-në dhe institucionet tjera për raportim të saktë të të dhënave të gjendjes civile në Regjistrin Civil. | 39 | Aktivitetetet e grupeve punuese KQZ-MPB për përmirësimin e LV-së | Inkorporimi i sistemit të adresave në Regjistrin Qendror Civil. Përmirësimi, saktësia dhe gjithë përfshirja në Listën e Votuesve | DOZ/DTI | Grupi punues për LV /KQZ | 18 Janar | 21 Dhjetor | Takime te permashketa te grupeve punuese | Se paku 6 takime te mbajtura | Buxheti I KQZ-së |

## SHTYLLA STRATEGJIKE 5: Pjesëmarrje në zgjedhje

### SYNIMI STRATEGJIK 1: Pjesëmarrje më e madhe në zgjedhje

| VEPRIMET STRATEGJIKE | | AKTIVITETET | PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE | DEPARTAMENTI / NJËSIA PËRGJEGJËS PËR ZBATIM | PËRGJEGJËS PËR MONITORIM | AFATI KOHOR | | TREGUESIT E PERFORMANCËS | | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | FILLIMI | PËRFUNDIMI | TREGUESI | CAQET/OBJEKTIVI I 2016 | Vlerësimi i buxhetit |
| 5.1.1 Vënia në funksion e programeve informuese për motivim të të gjithë votuesve për pjesëmarrje në votim | 40 | Fushata motivuese për rritjen e pjesmarrjes se grave ne zgjedhje | Motivimi i grave për pjesmarrje në zgjedhje | DOZ | KOZ/KQZ | 4 Korrik | 5 Dhejtor | n/a | n/a | Buxheti i KQZ-së (Rishikimi i Buxhetit) / Donator |
| 5.1.2 Rishikimi i praktikave të regjistrimit të votuesve për të lehtësuar pjesëmarrjen në zgjedhje dhe për të ofruar një bazë më të saktë për kalkulimin e pjesëmarrjes së votuesve në zgjedhje | 41 | Marrëveshje bashkëpunimi në mes KQZ-së dhe Ministrisë së Diasporës | Bashkëpunimi në mes KQZ-së dhe Ministrise se Diaspores, me qëllim të përfshirjes së pikave shpërndarëse në proceset zgjedhore, me qëllim të informimit të votuesve jashtë vendit,<br>Identifikimi i shoqatave, asociacioneve të ndryshme, si pika shpërndarëse,<br>Përfshirja e Ministrisë së Diasporës në procese zgjedhore, me qëllim të informimit të votuesve jashtë Kosovës,<br>Krijimi i një data baze të saktë për të dhënat e shoqatave dhe asociacioneve të ndryshme të mërgatës. | DOZ | KOZ/KQZ | 11 Janar | 15 Mars | Memorandumi i nënshkruar | 100% | Buxheti i KQZ-së |
| | 42 | Zhvillimi i aplikacionit online për aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës | Pjesmarrja më e madhe e votuesve me të drejt vote që gjenden jashtë Kosove | DOZ | KOZ/KQZ | 18 Janar | 12 Dhjetor | Projekti i hartuar dhe i implementuar | n/a | Buxheti i KQZ-së/Donator |

### SYNIMI STRATEGJIK 2: Qasje e barabartë dhe gjithëpërfshirëse në zgjedhje

| VEPRIMET STRATEGJIKE | | AKTIVITETET | PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE | DEPARTAMENTI / NJËSIA PËRGJEGJËS PËR ZBATIM | PËRGJEGJËS PËR MONITORIM | FILLIMI | PËRFUNDIMI | TREGUESI | CAQET/OBJEKTIVI I 2016 | Vlerësimi i buxhetit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.2.3 Sigurimi që të gjithë votuesit mund të caktohen në vendvotim fizikisht të qasshëm | 43 | Paraqitja hartografike të qendrave të votimit që kanë qasje për personat me aftësi të Kufizuara dhe me të gjitha specifikat tjera. | Ky projekt ka për qëllim të ketë tri funksione kryesore. Paraqitjen e informatave te rëndësishme për procesin zgjedhor ne mënyrë interaktive ne ueb, përkatësisht: Informatat zgjedhore, qasjen për personat me aftësi te kufizuara dhe rezultatet e zgjedhjeve. | DTI/DOZ/KT | KOZ/KQZ | 11 Janar | 29 Shkurt | Projekti i perfunduar | 100% | Buxheti i KQZ-së/IFES |

## SHTYLLA STRATEGJIKE 6: Inovacioni dhe teknologjia

### SYNIMI STRATEGJIK 1: Rritje e përdorimit të teknologjisë për operacione zgjedhore

| VEPRIMET STRATEGJIKE | | AKTIVITETET | PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE | DEPARTAMENTI / NJËSIA PËRGJEGJËS PËR ZBATIM | PËRGJEGJËS PËR MONITORIM | AFATI KOHOR | | TREGUESIT E PERFORMANCËS | | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | FILLIMI | PËRFUNDIMI | TREGUESI | CAQET / OBJEKTIVI I 2016 | Vlerësimi i buxhetit |
| 6.1.1 Përdorimi më efektiv i teknologjisë për përmbushjen e operacioneve zgjedhore | 44 | Platforma për modernizimin / digjitalizim e operacioneve zgjedhore. | Qëllimi i Projektit është të zhvillohet sistemi elektronik, i cili funksionimin tradicional e transformon në një funksionim elektronike duke e bërë automatizimin e veprimeve të brendshme të KQZ-së, e po ashtu edhe atyre të jashtme ne raport me qytetarët dhe subjektet politike, i cili funksionon përmes rrjetit te internetit dhe do te jete i lehte për tu përdorur për te gjithë akteret qe kane rol ne ketë projekt. Ndryshim e qendrës se votimit, duke eliminuar procedurat e deritanishme manuale.<br>Subjektet politike mund te bëjnë aplikimin online për certifikim, regjistrimin e kandidatëve, aplikimin për akreditim për vëzhgimin e zgjedhjeve, | DTI/ZRPPC/DOZ | KOZ/KQZ | 14 Janar | 16 Nentor | Projekti I miratuar dhe implementuar | 100% | Buxheti i KQZ-së / IFES |
| | 45 | Analizimi dhe përgaditja e Pilot - Projektit Skanimi i formularëve të rezultateve | Ky aktivitet ka per qellim analizimin e modaliteteve teknike dhe procedurale per te permbushur procesin e tabulimit te rezultateve ne menyre me te shpejte dhe te sakte. Pas analizimit do te behet pergaditja e projektit per buxhetim ose vendosjen ne listen e projekteve per prezantim tek donatoret, me qellim te implementimit ne Zgjedhjet Lokale 2017. | QNR/DTI | KOZ/KQZ | 5 Prill | 7 Dhjetor | Vlerësimi i rezultateve të pilot projektit(eve) të dorëzuara në KQZ | 75% | Buxheti i KQZ-së/Donator |
| | 46 | Hartimi dhe realizimi i Projektit - Regjistrimi dhe evidentimi i materialit zgjedhor (1. Pergaditja e Projektit 2. Implementimi) | Hartimi i projektit per regjistrimin dhe evidentimin e materialit zgjedhore, me qellim te gjurmimit ne kohe reale per vendndodhjen e materialit. Pas hartimit, projekti do te buxhetohet ose vendosjet ne listen e projekteve per prezantim tek donatoret, me qellim te implementimit ne Zgjedhjet Lokale 2017. | QNR/DTI/DAP | KOZ/KQZ | 15 Janar | | Vlerësimi i implementimit të projektit | 75% | Buxheti i KQZ-së/Donator |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 47 | Zhvillimi i Sistemit për menaxhimin e informatave të Subjekteve Politike | Zhvillimin e nje sistemi per menaxhimin e informatave te subjekteve politike ( themeluesit,mbajtjen e kuvendeve, organet, deget, etj) | ZRPPC/DTI | KÇL/KQZ | 18 Janar | | Rishikimi i numrit të kërkesave dhe specifikimeve të sistemit të përfunduara | 75% | Buxheti i KQZ-së/Donator |
| 6.1.3 Vënia në përdorim e teknologjisë për menaxhimin e informatave | 48 | Krijimi për nevoja të brendshme i një "harte" pasqyre gjeografike për ecurinë e zgjedhjeve ( kutitë e rinumëruara, ankesat, votat e dyfishta etj) | | QNR,KT,DOZ | KOZ/KQZ | 12 Janar | 22 Mars | Dokumenti me te dhenat i perfunduar | 100% | Buxheti i KQZ-së |
| **SYNIMI STRATEGJIK 2: Rritje e përdorimit të teknologjisë në shërbimet administrative** | | | | | | | | | | |
| | 49 | Zhvillimi i Sistemit për menaxhimin e financave | Zhvillimi i sistemit te menaxhimit të financave në KQZ paraqet një proces të rëndomtë të menaxhimit të financave i cili aplikohet në të gjitha institucionet publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në sofwer paraqiten proceset kryesore të cilat përbëjnë rrjedhën e punës së përditshme në menaxhimin e financave në KQZ. | DAP/DTI | KBF/KQZ | 6 Prill | 19 Tetor | Vlerësimi i implementimit të projektit | 100% | Buxheti i KQZ-së / Donator |
| **SYNIMI STRATEGJIK 3: Ngritje e njohurive në aplikimin e teknologjisë në zgjedhje** | | | | | | | | | | |
| 6.3.1 Realizimi i hulumtimeve lidhur me aplikimin e teknologjisë në proceset zgjedhore | 50 | Vlersim dhe funksionalizimi i infrastruktures te TI-së për zgjedhjet 2017 | Me qellim te pergaditjes se infrastruktures se TI-së per zgjedhjet e vitin 2017, nderrmerret nje evidentimi, vlersimi dhe funksionalizimi I pajisjeve te TI-së. | DTI/QNR | KQZ | 11 Korrik | 22 Shtator | Raporti per funksionalitetin e pajisjeve te TI-së I perfunduar | 100% | Buxheti i KQZ-së |
| | 51 | Hulumtim dhe studim fizibiliteti për përdorimin e teknologjisë ne zgjedhje | Hulumtimi i rasteve të studimit nga shtetet qe kane aplikuar perdorimin e teknologjise ne Procese zgjedhore.<br>Analizmi i mundesive te perdorimit te teknologjise ne kontekstin e Kosoves Nderrmarrja e hulumtimi sasior per te kuptuar perceptimin e votuesve dhe aktereve tjere ne lidhje me mundesie e perdorimit te teknologjise ne zgjedhje. | DTI/QNR/DOZ | KOZ/KQZ | 13 Janar | 16 Qershor | Raporti i hulumtimit I perfunduar | 100% | Buxheti i KQZ-së |
| | 52 | Pjesmarrja ne Konferencen E-vote 2016 | Kjo konferencë është një nga ngjarjet kryesore ndërkombëtare për ekspertët qe merren me aplikimin e teknologjise ne zgjedhje, e ne veqanti votimin elektronik nga e gjithë bota. | DTI/SKQZ | KOZ/KMJ/KQZ | 17 Tetor | 21 Tetor | Pjesmarrja ne Konference | 100% | Buxheti i KQZ-së |
| 6.3.2 Adaptimi i një kornize për zhvillimin dhe zbatimin e zgjidhjeve të TI-së në KQZ | 53 | Hartimi strategjisë se TI-së | Adaptimi i nje kornize për zhvillimin dhe zbatimin zgjidhjeve të TI-së ne KQZ. Strategjia a TI-së përcakton planin tre-vjeçar strategjik të departamentit të TI-së, e që përfshin objektiva të qarta dhe detajon synimet për zhvillimin e zgjidhjeve të TI-së dhe permiresimin e proceseve te brendshme ne KQZ -së | DTI/SKQZ | KQZ | 18 Janar | 14 Qershor | Plan i zgjidhjeve te TI-së i perfunduar | 100% | Buxheti i KQZ-së / Donator |

## SHTYLLA STRATEGJIKE 7: Bashkëpunimi me akterët e jashtëm

**SYNIMI STRATEGJIK 1: Partneritet dhe komunikim më i mirë me subjektet politike, shoqërinë civile dhe mediat**

| VEPRIMET STRATEGJIKE | | AKTIVITETET | PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE | DEPARTAMENTI / NJËSIA PËRGJEGJËS PËR ZBATIM | PËRGJEGJËS PËR MONITORIM | AFATI KOHOR | | TREGUESIT E PERFORMANCËS | | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | FILLIMI | PËRFUNDIMI | TREGUESI | CAQET / OBJEKTIVI I 2016 | Vlerësimi i buxhetit |
| 7.1.1 Përmirësimi i të gjitha proceseve të raportimit sipas legjislacionit | 54 | Shqyrtimi dhe Aprovimi i Raporteve te Auditimit | Shqyrtimi dhe aprovimi I raporteve të auditimit të brendshëm- Me planin vjetor të audtimit të brendshëm janë planifikuar pesë aktivitetet audituese të rregullta dhe një me kërkesë. Dinamika e realizimit të projekteve është e shtrirë në terë vitin dhe përmban datat e kryerjes së aktiviteteve audituese.Në datet 15.04.2016,15.07.2016 dhe 15.10.2016 secili raport I AB I kryer individualisht por edhe raporti tremujor i secilës periudhë shqyrtohet dhe aprovohet në KA | AB/SKQZ | KA/KQZ | 15 Prill | 15 Tetor | Raportet e shqyrtuara dhe te aprovuara | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 55 | Miratimi i Planit Strategjik 2017-2019 dhe Vjetor të Auditimit per vitin 2017 | Plani strategjik i AB 2017-2019 dhe plani vjetor 2017, shqyrtohen dhe aprovohen nga KA me datë 15.10.2016 dhe nga KQZ me 30.10.2016. | AB/SKQZ | KA/KQZ | 15 Tetor | 30 Tetor | Plani strategjik dhe plani vjetor të aprovuara | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 56 | Raporti vjetor i Komitetit të Auditimit | Raporti vjetor i Komitetit të Auditimit për vitin 2015, përgatitet dhe dorëzohet për shqyrtim dhe aprovim në KQZ me 31.01.2016. | AB/SKQZ | KA/KQZ | 15 Janar | 31 Janar | Raporti i aprovuar | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 57 | Shqyrtimi i implementimit te rekomandimeve te Zyrës se Auditorit gjeneral të vitit 2015 | Shqyrtimi I tretë I implementimit të rekomandimeve të AGJ për vitin 2014 në KA, bëhet me 31.01.2016,raportimi I zbatimit të rekomandimeve të AGJ për vitin 2014 në datë 15.02.2016 | AB/SKQZ | KA/KQZ | 31 Janar | 15 Shkurt | n/a | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 58 | Hartimi i dosjes se informimit publik | Ne baze të Ligjit NR. 03/L-073 Për Zgjedhjet e Pergjithshme në Republikën e Kosovës, neni 43.2 ZRPP harton përbërjen e dosjes se informit publik e cila publikohet ne ueb faqen e KQZ-së. | ZRPPC | KÇL/KQZ | 2 Prill | 19 Maj | Dosja e publikuar ne ueb faqe | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 59 | Raporti për Kuvendin e Republikës së Kosovës | Duke u bazuar në obligimin e përcaktuar në nenin 63.10 të Ligjit NR. 03/L-073 Për Zgjedhjet e Pergjithshme në Republikën e Kosovës, KQZ-ja i përgatit Kuvendit të Kosovës një raport vjetor dhe atë në muajin prill. Raporti përmban informata lidhur me aktivitetet e KQZ-së dhe rekomandimet që KQZ-ja i sheh si të përshtatshme që të trajtohen në Kuvend. | SKQZ | KQZ | 26 Janar | 25 Prill | Raporti ihartuar dhe miratuar nga KQZ | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 60 | Raporti vjetor për Kuvendin e Kosovës për shpërndarjen dhe shpenzimin e mjeteve nga fondi për financimin e subjekteve politike | Bazuar ne Ligjin 03/L174 neni 15, KQZ-ja duhet ti publikoj të gjitha raportet vjetore financiare së bashku me deklaratën e auditimit të subjekteve politike në faqen zyrtare të saj | ZRPPC/DAP | KBF/KQZ | 11 Qershor | 27 Qershor | Raporti i shqyrtuar dhe miratuar nga KQZ | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 61 | Raportimi i Pasqyrave financiare te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve për vitin 2015 | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përgatit, shqyrton dhe aprovon Raportin vjetor financiar per vitin 2015.Këtë raport e dorëzon nw MF më së voni me 31 janar 2016. | DAP | KBF/KQZ | 15 Janar | 31 Janar | Raporti i pasqyrave i shqyrtuara dhe miratuar nga KQZ | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 62 | Raportimi i progresit nga KQZ-ja për Planin e Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit | Raportimi për progresin e KQZ-se, ne Ministrinë e Integrimeve Evropiane, lidhur me pyetësorët për DPSA dhe PV për MSA | DÇL | KÇL/KQZ | 15 Janar | 26 Dhjetor | Raporte te dorezuara | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| 7.1.2 Pjesëmarrja efektive në organizime me qellim të promovimit të zgjedhjeve demokratike në Kosovë | 63 | Shënimi i Ditës Globale të zgjedhjeve | Shënimi i kësaj dite përmes organizimit të një konference/tryeze të gjerë me përfaqësues të institucioneve, partive politike, OJQ-ve, etj. – ku do të prezantohen trended e pjesëmarrjes gjinore në Zgjedhjet në Kosovë. | DOZ | KOZ/KQZ | 16 Janar | 4 Shkurt | Konference/tryez e mbajtur | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| 7.1.3 Fuqizimi i komunikimeve të rregullta me OJQ-të dhe mediat | 64 | Nxjerrja e një fletushke elektronike për aktivitet tre mujore dhe shpërndarja tek subjektet politike dhe OJQ-të dhe akterët tjerë. | Kjo fletushkë do të përmbledhë aktivitetet kryesore të KQZ-së të zhvilluara gjatë periudhave të caktuara kohore (janar-mars; prill-qershor; korrik-shtator; dhe tetor-dhjetor. | Zedhenesi/DOZ | KOZ/KQZ | 7 Mars | 26 Dhjetor | Fletushkë e publikuar | Kater fletushka periodike te publikuara | Buxheti i KQZ-së |
| 7.1.4 Fuqizimi i komunikimeve të rregullta me subjektet politike | 65 | Takime të rregullta (tre mujore) me subjektet politike | Zyra mban takime të rregullta me përfaqësues të Subjekteve Politike me qëllim të njoftimit lidhur me obligimet e subjekteve. | ZRPPC | KQZ | 15 Janar | 19 Dhjetor | Takime te mbajtura | Se paku 3 takime te mbajtura | Buxheti i KQZ-së |
| 7.1.5 Përmirësimi i menaxhimit të përgjegjësive të ZRPPC-së në raport me subjektet politike | 66 | Monitorimi dhe informimi lidhur me mbajtjen e kuvendeve zgjedhore të partive politike | Zyra monitoron ecurinë e mbarëvajtjes se kuvendeve zgjedhore dhe përpilon raport, ku e informon KQZ-në. | ZRPPC | KQZ | 5 janar | 26 Dhjetor | Kuvende te monitoruara | Se paku 10 Kuvende te monitoruara | Buxheti i KQZ-së |
| | 67 | Raportet e Auditimit – Publikimet | | ZRPPC | KQZ | 4 Korrik | 30 Shtator | Raportet e publikuara | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 68 | Trajnimi i zyrtareve financiar të SP-ve | Sipas nenit 40.7 të Ligjit NR. 03/L-073 Për Zgjedhjet e Pergjithshme në Republikën e Kosovës, të gjithë zyrtarët për financa ndjekin një trajnim për llogaritjen dhe auditimin, të organizuar nga Zyra menjëherë pas emërimit të tyre. | ZRPP | KÇL/KQZ | 6 Shkurt | 16 Shkurt | Zyrtaret financiar te trajnuar | Se paku 15 zyrtar financiar te trajnuar | Buxheti i KQZ-së |
| **SYNIMI STRATEGJIK 3: Promovim më i mirë i KQZ-së në nivel ndërkombëtarë** | | | | | | | | | | |
| 7.3.1 Të rrisim pjesëmarrjen në ngjarje zgjedhore rajonale dhe ndërkombëtare me qellim të këmbimit të përvojave më të mira | 69 | Pjesëmarrje ne Konferencën vjetore të ACEEEO | | SKQZ | KMJ/KQZ | 5 Shtator | 30 Shtator | Pjesmarrja ne Konference | Aktivitet i rregullt vjetor | Buxheti i KQZ-së |
| | 70 | Vëzhgimi i Zgjedhjeve dhe pjesëmarrja ne aktivitete si trajnime, konferenca që merren me fushen e zgjedhjeve | Me qelim te marrjes se pervojave dhe praktikave te mira, KQZ ben vezhgimin e proceseve zgjedhore ne shtetet e rajonit. | SKQZ | KMJ/KQZ | 16 Janar | 26 Dhjetor | Zgjedhje te vezhguara | Të pakten tri procese te vezhguara | Buxheti i KQZ-së |
| | 71 | Organizimi i një konference me TMZ-të që KQZ-ja ka bashkpunim | Konferencë 2-3 ditore ku shtetet apo TMZ-të pjesëmarrëse do të prezantonin praktikat e vendeve të tyre në tema të caktuara. | SKQZ | KMJ,KOZ/KQZ | 11 Prill | 20 Qershor | Konferenca e mbajtur | Pjesmarres nga TMZ te se paku tri vendeve | Buxheti i KQZ-së |
| 7.4.1 Inicimi i mekanizmave të koordinimit me institucionet vendore relevante | 72 | Zhvillimi i Platformës për Monitorim të Shkeljeve në Zgjedhje | Platforma për Monitorimin e Shkeljeve në Zgjedhje, e bazuar në sistemin Ushahidi, ka për qëllimin grumbullimin e të dhënave për shkelje të proceseve zgjedhore gjatë gjithë ciklit të zgjedhjeve. Kjo platformë do të mundësoj raportimet nga tereni, për shkelje dhe incidente të ndryshme, përmes raportimit në uebfaqe, email, apo edhe sms.<br>Si dhe krijimi i grupit punues per shkelje zgjedhore. | DTI/DÇL/KT/QNR | KOZ/KQZ | 15 janar | 14 Prill | Platforma e zhvilluar | Se paku rastet nga viti 2014 te pasqyruar ne Platformë | Buxheti i KQZ-së/ IFES |

## SHTYLLA STRATEGJIKE 8: Korniza Ligjore

### SYNIMI STRATEGJIK 3: Kornizë e plotë dhe efektive nënligjore

| VEPRIMET STRATEGJIKE | | AKTIVITETET | PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE | DEPARTAMENTI / NJËSIA PËRGJEGJËS PËR ZBATIM | PËRGJEGJËS PËR MONITORIM | AFATI KOHOR | | TREGUESIT E PERFORMANCËS | | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | FILLIMI | PËRFUNDIMI | TREGUESI | CAQET/OBJEKTIVI I 2016 | VLERËSIMI I BUXHETIT |
| 8.3.1 Të përmirësohet korniza nënligjore | 73 | Rishikimi i Udhezimit Administartiv 01/2012 per Zevendesimin e antareve të kuvendeve komunale | Harmonizimi Udhëzimit Administrativ me Rreguloren e Punës të KQZ-së . | DÇL | KÇL | 5 Prill | 17 Qershor | Udhëzimi i rishikuar | 100% | Buxheti i KQZ-së |

## Aktivitetet tjera të mbeshtetura nga OSBE

| | AKTIVITETET | PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE | DEPARTAMENTI / NJËSIA PËRGJEGJËS PËR ZBATIM | PERGJEGJES PER MONITORIM | AFATI KOHOR | | TREGUESIT E PERFORMANCËS | | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | FILLIMI | PËRFUNDIMI | TREGUESI | CAQET/OBJEKTIVI I 2016 | VLERËSIMI I BUXHETIT |
| 74 | Publikimi i historikut të zgjedhjeve 2000-2014 | Misioni I OSBE-se bashku me KQZ-ne do te finalizoje dhe publikojë doracakun mbi historikun e Zgjedhjeve nga viti 2000-2014. Ky doracak përmban te dhëna teknike te zgjedhjeve I cili shërben për planifikim më të mire te aktiviteteve në të ardhmen dhe u ofron akterëve zgjedhorë njohuri me të mëdha mbi zgjedhjet. | OSBE / SKQZ | KQZ/OSBE | Janar | Maj | Doracaku/Historiku | Publikimi I historikut | OSBE |
| 75 | Punëtori me Asambletë Komunale mbi zëvendësimin e anëtarëve të Asambleve Komunale | Në bashkëpunim me ZLKZ-të, përfaqësuesit e AK do te njoftohen mbi rolin dhe procedurat e zëvendësimit të këshilltarëve komunal | OSBE/ZLKZ/SKQZ | KQZ | Mars | Prill/Maj | Së paku 80% te zyrtarëve marrin pjesë | Zyrtarët e AK te njoftuar mire dhe forcimi i bashkëpunimitne mes AK dhe ZLKZ/KQZ është ngritur | OSBE |
| 76 | Trajnim për Menaxhimin e ciklit të projektit | Trajnimi do te fokusohet ne zhvillimin e projektit, monitorimit te implementimit dhe raportimi/vlerësimi ne kohë mbi aktivitetet | OSBE/SKQZ | KQZ/OSBE | Maj | Qershor | Së paku 80% te zyrtarëve marrin pjesë | Ngritja e aftësive ne menagjimin e projekteve | OSBE |
| 77 | Trajnimi mbi aspektin gjinor ne lidhje me proceset zgjedhore | Vazhdimësi trajnimeve nga viti 2015, me një aspekt të veçantë mbi proceset zgjedhore nga perspektiva e barazisë gjinore. Trajnimi do te ketë për bazë edhe metodologjinë e OSBE-ODIHR mbi barazinë gjinore me pikëpamje për të siguruar rekomandime konkrete për zgjedhjet e ardhshme. | OSBE/SKQZ | KQZ/OSBE | Shtator | Shtator | Së paku 80% te zyrtarëve marrin pjesë | Rekomandime konkrete per KQZ-në | OSBE |
| 78 | Punëtori mbi mësimet e nxëna dhe vlersimet per vitin 2016 | Shqyrtimi dhe vlerësimi i aktiviteteve te vitit 2016 dhe planifikimi i aktiviteteve per 2017 | KQZ/SKQZ/OSBE | KQZ/OSBE | Nëntor | Nëntor | Raporti mbi aktivitetet i elaboruar dhe prezantimi i rekomandimeve per 2017 | Aktivitet i rregullt | OSBE |